

**FLUITECH ITALIA SHPK**

**NIPT: L82211022A**

**Rezidenca "Kodra e Diellit", Rruga e Ullinjve, D6.  
Tirane**

## **KONTRATE DHURIMI KUOTASH**

Sot, ne date 05/08/2021 (dymije e njezet e nje), në selinë e shoqërisë FLUITECH ITALIA shpk, u mblohdhën palet e poshtë shënuara:

### **Dhuruesi:**

Z. Leonardi Lolaj, lindur më 09/02/1981 në Tirane dhe rezident në Rr. Ali Demi, mbajtës i kartes se identitetit nr. 033790881, madhor me aftësi të plotë juridike për të vepruar,

### **Perfituesi:**

Z. Giuseppe Tubito, lindur më 19/04/1977 në Mottola, Itali dhe banues në Tirane ne adresen "Kodra e Diellit", shtetas Italian, mbajtës i kartes se identitetit nr. AZ0184220 leshuar ne Castellaneta ne date 05.09.2019, madhor me aftësi të plotë juridike për të vepruar,

Palët redaktuan këtë kontratë dhurimi kuotash bazuar në nenin 761 të Kodit Civil.

Dhuruesi, Leonardi Lolaj është pronar dhe zotëron kuota në shoqërinë "FLUITECH ITALIA" shpk si më poshtë:

Ortaku Leonardi Lolaj – zoterues i 1 (një) kuote, në vlere 3,000,000 (tremilion) lek që përbën 100% të kapitalit.

Sot, ortaku Leonardi Lolaj i dhuron Z. Giuseppe Tubito, 100% të totalit të kapitalit të zotëruar prej tij në vlerën 3,000,000 (tremilion) lekë. Kjo per shkak te mos permbushjes te disa kushteve kontraktuale nga ana e Z. Tubito qe lidhen me sjelljen e klienteve te rinj ne kompani dhe zhvillimin e saj. Z. Giuseppe Tubito pranon dhurimin e pjesës së mësipërme.

Ortakët e shoqërisë dhe kapitali i saj, tashmë paraqitet si më poshtë:

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie përbehet në para (Lekë) në shumën prej 3,000,000 (tremilion) Lekë me 1 (nje) pjesë.


Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku Giuseppe Tubito – zoterues i 1 (një) kuote, në vlere 3,000,000 (tremilion) lek që përbën 100% të kapitalit.

Të gjithë janë dakord me këtë akt dhurimi të cilin e përpilojnë me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur dhe pasi e lexojnë me zë të lartë e firmosin pa vërejtje.

### **Dhuruesi:**

Leonardi Lolaj



### **Perfituesi:**

Giuseppe Tubito

